



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KONKURENCËS  
KABINETI

**NJOFTIM PËR SHTYP**

**Rasti:** Transferimi i Veprimtarisë Ekonomike të Degëve të shoqërive HIPPO Markets (shtatë prej pikave) tek shoqëria SPAR Albania Shpk.

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është depozituar shkresa me Nr. 663 Prot., protokoll i AK, datë 03.12.2019 nga shoqëria SPAR Albania Shpk, ku jemi njoftuar mbi marrëveshjen e transferimit të Veprimtarisë Ekonomike të Degëve të shoqërive HIPPO Markets (shtatë prej pikave) tek shoqëria SPAR Albania Shpk.

Për realizimin e transaksionit janë lidhur 7 (shtatë) Marrëveshje nga shoqëritë HIPPO Markets me shoqërinë SPAR Albania Shpk.

Palët pjesëmarrëse:

**Pala Shitëse: HIPPO MARKETS** është një rrjet supermarketesh i themeluar në Shqipëri në Nëntor të vitit 2015. Pjesë e rrjetit HIPPO Markets janë shtatë supermarkete, të cilat ofrojnë një gamë të gjerë artikujsh për klientët e tyre. Këtu përfshihen atikujt ushqimorë dhe jo-ushqimorë, produktet e enëve të kuzhinës dhe produktet kozmetike. Të gjitha supermarketet ndodhen në Tiranë dhe secila prej tyre operon si njësi e veçantë ekonomike-ligjore, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, si më poshtë: *Meleon Tirana Shpk, Meleon Shpk, HIPPO Shpk, XL Market Shpk, MAXI HIPPO Shpk, HIPPO STUDENTI Shpk* dhe *Hippo Tregu Elektrik Shpk*,

**Pala Blerëse: SPAR ALBANIA SHPK (“SPAR AL”)** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, e cila zotërohet 100% te kapitalit prej shoqërisë Balfin SHPK. SPAR AL nuk zotëron kontroll në asnjë shoqëri tjetër. SPAR AL ka për objekt aktiviteti shitjen me shumicë dhe pakicë të produkteve ushqimore dhe jo-ushqimore, produkte për kafshë etj, nëpërmjet ngritjes dhe administrimit të marketeve, supermarketve dhe hipermarketeve “SPAR” në Shqipëri dhe jashtë saj. Gjithashtu në aktivitetin e SPAR AL përfshihet import-eksport dhe prodhim i produkteve jo-ushqimore, stokimi dhe ruajtja e produkteve ushqimore, transport i mallrave dhe udhëtarëve brenda dhe jashtë vendit etj.

Shoqëritë HIPPO Markets (shtatë prej pikave) do të transferojnë veprimtaritë ekonomike të degëve të ndërmarrjes tek shoqëria SPAR Albania Shpk. Veprimtaritë ekonomike që do të transferohen,

do të veprojnë dhe funksionojnë si njësi autonome, pra të pavarura nga shoqëritë nga të cilat do të shkëputen. Dega e ndërmarrjes do ti transferohet e lirë nga çdo barrë dhe detyrim shoqërisë SPAR Al, përveç detyrimeve të përcaktuara posaçërisht në Marrëveshjet përkatëse.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të Ligjit 9121/2003 “Për mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

Për sa më sipër, ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara, që brenda pesë ditëve nga shpallja e njoftimit, të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

**Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën [competition@caa.gov.al](mailto:competition@caa.gov.al).**